

VENDIM
Nr. 132, datë 29.4.2026

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “FONDI PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME PËR VITIN 2026”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Besnik Çina anëtar;
- Znj. Keida Qirko anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar,

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 29.4.2026, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, mori në shqyrtim njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore të njoftuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) e mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

I. Procedura

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) me shkresën nr. 652, datë 17.4.2026, ka njoftuar skemën e ndihmës shtetërore “Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2026”. Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e ndihmës shtetërore, në bazë të planit të ndihmës shtetërore të sipërpërmendur.

II. Përshkrimi i masës

2. *Qëllimi*: Skema synon përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta për fondin e mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) mbështetjen me grante për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) për rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin dhe rinovimin e teknologjisë, me qëllim nxitjen e eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve, lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm.

3. *Baza ligjore e planit të ndihmës*: Plan i ndihmës shtetërore mbështetet VKM-në nr. 225, datë 1.4.2026, “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2026”.

4. *Kohëzgjatja*: Skema e ndihmës do të zbatohet gjatë vitit 2026.

5. *Dhënësi i ndihmës*: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.

6. *Autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës*: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

7. *Përfituesit*: Përfitues janë të gjithë NMVM-të, të cilat plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën 5, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, si dhe kriteret e veçanta të parashikuara në VKM-në nr. 225/2026.

8. *Shtrirja sektoriale dhe territoriale*: Projekti do të zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë në të gjithë sektorët e ekonomisë.

9. *Forma dhe vlera e ndihmës*: Skema e mbështetjes me ndihmë shtetërore përfshin shpenzimet korrente të programit ekonomik (04130) “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit në vlerën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, që mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesë qind mijë) lekë për një përfitues të skemës.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

10. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për

ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

11. Neni 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, përcakton, se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo formë e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

12. Gjithashtu neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹ përcakton, se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

13. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore, b) avantazhi ekonomik, c) përzgjedhja; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

14. Plan i ndihmës ofrohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe financohet nga buxheti i shtetit (burimeve shtetërore) përmes programit ekonomik (04130), “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”, në shumën gjithsej 100,000,000 lekësh. Për përfituesit e ndihmës, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), skema parashikon mbulimin e kostove të miratuara deri në 100%, por jo më shumë se 2,500,000 lekë për një aplikues. Ky financim lejon që ndërmarrja të përballojë me burime shtetërore një pjesë të kostove, të cilat në kushte normale tregu do të duhej të përballohen me burimet e veta, si: shpenzimet për certifikime, trajnime dhe/ose platforma “e-Commerce”. Duke qenë se këto ndërmarrje ofrojnë mallra dhe shërbime në treg, ato konsiderohen si “ndërmarrje” në kuptimin e legjislacionit për ndihmën shtetërore. Skema është selektive sepse nuk është e hapur për të gjithë operatorët ekonomikë në treg, por kufizohet vetëm te ndërmarrjet që plotësojnë kriteret e ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, dhe që kanë plane biznesi të veçanta që fokusohen te nxitja e eksportit dhe inovacioni. Gjithashtu, përjashtohen ndërmarrjet që kanë përfituar nga burime të tjera për të njëjtat aktivitete. Përmes skemës, ndërmarrjet e përzgjedhura përfitojnë një pozicion të favorizuar ndaj konkurrentëve të tjerë që operojnë në të njëjtin sektor. Duke qenë se masa synon nxitjen e eksportit, skema konsiderohet se ka ndikim të drejtpërdrejtë në tregti. Produktet dhe shërbimet e NMVM-ve përfituese janë objekt i shkëmbimeve tregtare ndërkombëtare (veçanërisht me vendet e rajonit dhe Bashkimin Evropian), si rrjedhojë skema ka potencial për të shtrembëruar ose kërcënuar konkurrencën në treg. Ky efekt është pasojë e forcimit të pozicionit të këtyre ndërmarrjeve në raport me operatorët e tjerë ekonomikë, që nuk përfitojnë nga skema e ndihmës.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se në bazë të nenit 4, të ligjit 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar plani i ndihmës është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

15. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8/1, “Ndihma shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar. Bazuar në pikën 2, të nenit 8/1, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, ndihma shtetërore lejohet në përputhje me kushtet dhe intensitetet e përcaktuara në VKM-në nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”.

Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”, përcaktohet se nëse plotësohen kushtet e kreut II, dhe neneve të rregullores mund të lejohet ndihma shtetërore për kategoritë e ndihmës, si vijon:

1. Neni 11 “Ndihma për investime”, me kusht që:

- Kostot e pranueshme të përfshijnë njëren nga/ose të dyja kostot e mëposhtme:

a) Kostot e investimit në asete të prekshme dhe të paprekshme;

b) Kostot e parashikuara të pagave në lidhje me punësimin e krijuar drejtpërsëdrejti nga projekti i investimit, të përlllogaritura gjatë një periudhë dyvjeçare.

- Një investim konsiderohet si kosto e pranueshme, me kusht që të jetë:

a) Një investim në asete të prekshme dhe/ose të paprekshme për ngritjen e një ndërmarrjeje të re, apo zgjerimin e një ndërmarrjeje ekzistuese, për të diversifikuar prodhimin e një ndërmarrjeje me produkte të reja shtesë ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të një ndërmarrjeje ekzistuese; ose

b) Blerje e aseteve, që i përkasin një ndërmarrjeje, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. ndërmarrja është mbyllur, ose do të mbyllet nëse nuk do të ishte blerë;

ii. asetet janë blerë nga një palë e tretë që nuk ka lidhje me blerësin;

iii. transaksioni është kryer në përputhje me kushtet e tregut.

- Asetet e paprekshme duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Të përdoren vetëm në ndërmarrjen që ka përfituar ndihmën;

b) Të konsiderohen si asete të amortizueshme;

c) Të blihen, në përputhje me kushtet e tregut, nga një palë e tretë, që nuk ka lidhje me blerësin;

ç) Të përfshihen në asetet e ndërmarrjes për të paktën tre vjet.

- Vendet e punës të krijuara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti i investimit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Të krijohen brenda tre vjetëve nga koha e përfundimit të investimit;

b) Rritjen neto të numrit të punonjësve në ndërmarrjen në fjalë, në krahasim me mesataren e 12 muajve të mëparshëm;

c) Vendet e punës duhet të ruhen për një periudhë minimale trevjeçare nga data e plotësimit për herë të parë.

- Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë:

a) 20% të kostove të pranueshme për ndërmarrjet e vogla;

b) 10% të kostove të pranueshme për ndërmarrjet e mesme.

2. Nenin 13 “Ndihma për këshillim në favor të NVM-së”, me kusht që:

- Intensiteti i ndihmës nuk tejkalon 50% të kostove të pranueshme;

- Kostot e pranueshme janë ato të shërbimit të këshillimit të siguruara nga konsulentë të jashtëm.

- Shërbimet përkatëse nuk duhet të jenë një aktivitet i vazhdueshëm ose periodik dhe as nuk duhet të jenë të lidhura me kostot e zakonshme operacionale të ndërmarrjes, si shërbimet e rregullta për këshillim tatimor, ligjor ose promovuese.

Në kreun II, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”, përcaktohet, se:

- Ndihma konsiderohet transparente kur jepet në formën e grantit etj., kur Ekuivalenti Bruto i Grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi përpara dhënies së saj. Ky kusht përmbushet sepse ndihma është në formën e grantit. AIDA do të llogarisë EBG-në për çdo përfitues përpara dhënies së ndihmës.

- Ndihma shtetërore ka efekt nxitës kur përfituesi ka dorëzuar një aplikim me shkrim pranë dhënësit përpara fillimit të punimeve të projektit. Ky aplikim përmban të gjithë informacionin e detyrueshëm: emrin/madhësinë e ndërmarrjes, përshkrimin dhe vendndodhjen e projektit, listën e kostove dhe shumën e fondit publik të kërkuar. Ky kusht plotësohet, sepse përfituesi duhet të dorëzojë aplikimin me shkrim pranë AIDA-s.

- Të gjitha vlerat e përdorura për kostot e pranueshme llogariten para zbritjes së taksave apo detyrimeve të tjera. Kostot mbështeten në dokumentacion justifikues të qartë dhe të përditësuar. Ky kusht plotësohet sepse kostot e pranueshme llogariten para zbritjes së taksave.

- Ndihma shtetërore për këtë skemë mund të mblidhet me ndihma të tjera vetëm nëse ato mbulojnë kosto të ndryshme të identifikueshme. Në rastet kur mbulojnë të njëjtat kosto, shuma totale e mbledhur nuk tejkalon intensitetin maksimal të lejuar nga kjo rregullore. Ndihma nuk mblidhet me ndihmë “*de minimis*” për të njëjtat kosto, nëse kalohet pragu i intensitetit të kreut III. Ky kusht plotësohet sepse ndihma shtetërore për këtë skemë do të mblidhet me ndihma të tjera vetëm nëse ato mbulojnë kosto të ndryshme të identifikueshme.

- Dhënësi i ndihmës është i detyruar të publikojë në faqen zyrtare informacionin përmbledhës, tekstin e plotë të masës. Ky informacion duhet të publikohet brenda 6 muajve dhe të ruhet për një periudhë 10-vjeçare nga data e dhënies së ndihmës. Ky kusht plotësohet sepse skema do të publikohet në faqen zyrtare të AIDA-s.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 8/1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8/1, 22, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit “Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2026”, të miratuar me VKM-në nr. 225, datë 1.4.2026, “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kritereve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2026”.

2. Në përputhje me nenet 11 dhe 13, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”, AIDA të identifikojë kostot e pranueshme të ndihmës shtetërore dhe mbi bazën e tyre të përcaktohet intensiteti i ndihmës së lejuar të skemës së ndihmës shtetërore.

3. Ndihma shtetërore nuk do të mblidhet me ndihmën “*de minimis*” për të njëjtat kosto, nëse kalohet pragu i intensitetit të kreut III, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore’”.

4. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

5. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari